R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE SIGURISË PUBLIKE

Nr. 2545/6 prot. Tiranë, më 27.10.2026

REKOMANDIM

Nr. 65, datë 27.10.2026

PËR KONTROLLUESIN
"NISMA PËR NDRYSHIM SHOQËROR ARSIS"

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"[1] (në vijim "Ligji"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" (në vijim "Kodi i Procedurave Administrative"), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit "Nisma për ndryshim shoqëror ARSIS" (në vijim "Kontrolluesi"),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 181, datë 11.09.2026, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri"), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e hetimit administrativ dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një organizatë jofitimprurëse, e themeluar me vendimin nr. 5260, datë 11.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

[1] Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjithë subjektet e ligjit, të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

Shoqata, në cilësinë e kontrolluesit, ka si objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të individëve dhe grupeve të mënjanuara, si dhe të sigurojë zgjerimin e pjesëmarrjes së shtresave në nevojë në shoqëri. Qëllimi i shoqatës lidhet me fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmave efektive që përkrahin fëmijët dhe familjarët e tyre, krijimin e hapësirave për edukimin qytetar dhe zhvillimin e rinisë e të gruas, krijimin e programeve të posaçme për fuqizimin e familjes dhe grupeve të mënjanuara të shoqërisë etj.

Gjithashtu, Kontrolluesi ka si qëllim ofrimin e përkrahjes në arsim, shëndetësi, shërbime dhe programe shoqërore, punësim, strehim, shërbime ligjore falas, përkrahje administrative etj., nëpërmjet fuqizimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmave që përkrahin familjarët e tyre, si dhe shtresave të tjera vulnerabël.

2. Kontrolluesi, në funksion të veprimtarisë dhe përmbushjes së detyrave ligjore të tij, përpunon të dhëna personale për personat "përfitues", sipas kategorive: "emër", "mbiemër", "data e lindjes", "nr. i identifikimit", "gjinia", "vendlindja", "shtetësia", "adresa", "certifikata familjare", si dhe të dhënat sensitive, si: "vlerësimi psikologjik", "gjendja shëndetësore" etj.

   Shoqata përpunon të dhëna personale në mënyrë manuale dhe elektronike. Për kategorinë e subjekteve të të dhënave "përfitues", përpunimi i të dhënave personale të tyre kryhet në mënyrë manuale, të administruara në dosje të krijuara posaçërisht për këtë qëllim.

3. Kontrolluesi ka vënë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ një dokument me titull **"**Menaxhimi i të dhënave dhe politika e mbrojtjes". Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtij dokumenti rezulton se në të janë përcaktuar rregulla dhe udhëzime lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të veprimtarisë së Kontrolluesit.

   Megjithatë, konstatohet se dokumenti i referohet ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr.124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim "Ligji").

   Për sa më sipër, dokumentacioni i brendshëm i Kontrolluesit që përcakton rregulla dhe procedura për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jetë i përditësuar dhe në përputhje me kuadrin ligjor aktual në fuqi, veçanërisht me kërkesat e Ligjit.

   Nga shqyrtimi i seksionit "Qëllimi dhe fushëveprimi" të dokumentit konstatohet se janë përcaktuar kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, por nuk rezulton të jenë përcaktuar afate konkrete ose kritere të përcaktuara për ruajtjen e tyre, në raport me qëllimet për të cilat këto të dhëna përpunohen.

   Mungesa e përditësimit të referencave ligjore në dokumentacionin e brendshëm, si dhe mungesa e përcaktimit të afateve të ruajtjes së të dhënave personale në përputhje me qëllimet e përpunimit, vlerësohen në kundërshtim me parimin e kufizimit të ruajtjes, të parashikuar në pikën 5 të nenit 6 të Ligjit, sipas të cilit të dhënat personale duhet të mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave, për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat të dhënat përpunohen.

4. Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ kontratën e shërbimit të nënshkruar me personin fizik “ ”, me objekt “*Ofrim i shërbimeve profesionale IT për mirëmbajtjen dhe administrimin e pajisjeve elektronike të Nismës ARSIS*”.

   Nga shqyrtimi i kontratës së mësipërme rezulton se në të nuk janë reflektuar rolet mes palëve si kontrollues dhe përpunues të të dhënave personale, si dhe detyrimet e përgjegjësitë që secila palë duhet të ketë gjatë procesit të përpunimit të të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 26 të Ligjit.

   Gjithashtu, mospërfshirja e këtyre elementeve në kontratë është në kundërshtim edhe me dispozitat e Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, të ndryshuar (në vijim “Udhëzimi nr. 19”), në të cilin gjendet modeli standard i kontratës që duhet të përdoret në raste të tilla, si dhe përcakton elementet dhe garancitë minimale që duhet të përmbajë kjo marrëveshje, në mënyrë që të garantohet përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale.

5. Grupi i hetimit administrativ konstatoi se Kontrolluesi administron një sistem video-survejimi (CCTV), i përbërë nga 8 kamera. Nga verifikimi në vend i sistemit CCTV, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka miratuar një rregullore të brendshme për administrimin, aksesin, ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave imazh/video të përpunuara përmes këtij sistemi, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 30.04.2025, të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejimit” (në vijim “Udhëzimi nr. 3”).

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me pikën 1 të neneve 33 dhe 34 të Ligjit.

   Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 33 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të caktojë një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave personale, për shkak se aktivitetet e tij kryesore përfshijnë përpunimin e të dhënave personale, që kërkojnë monitorim të rregullt e sistematik të subjekteve, si dhe përpunimin e të dhënave sensitive në një shkallë të gjerë.

   Gjithashtu, bazuar në pikën 3 të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të publikuar të dhënat e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre sipas këtij Ligji, si dhe për t’ia njoftuar ato Zyrës së Komisionerit.

7. Konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e shkronjave “c” dhe “ç” të nenit 34 të Ligjit dhe pikës 2 të nenit 5 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesit i është lënë afat të depozitojë pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ. Në lidhje me konstatimet e dërguara, Kontrolluesi ka paraqitur pretendimet shkresore, si vijon:

- *Referuar konstatimit tonë mbi përditësimin dhe rishikimin e dokumentit "Menaxhimi i të Dhënave dhe Politikat e Mbrojtjes", në lidhje me përcaktimin e afateve të ruajtjes së të dhënave dhe parashikimit të kërkesave të tjera në përputhje me Ligjin, Kontrolluesi ka marrë masa duke miratuar dokumentin "Politikat e Mbrojtjes së të Dhënave Personale", duke marrë si referencë ligjin nr. 124/2024. Megjithatë, nga ky dokument konstatohet se nuk janë përcaktuar qartë nivelet e aksesit, specifikisht për çdo subjekt që përpunon të dhëna personale, masat teknike dhe organizative të sigurisë, si dhe përgjegjësitë e personave të autorizuar. Gjithashtu, në këtë dokument nuk janë hartuar rregulla mbi administrimin e Regjistrit të Veprimtarive të Përpunimit, sipas nenit 27 të Ligjit, apo procedura për menaxhimin e cenimeve të të dhënave personale dhe marrëdhëniet me përpunuesit, në përputhje me nenet 26 dhe 29 të Ligjit.*

- *Në lidhje me konstatimin tonë referuar marrëdhënies kontraktuale me përpunuesin, z. , nga ana e Kontrolluesit janë marrë masa për të nënshkruar një shtesë kontrate, duke marrë si referencë Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit, si dhe nenin 26 të Ligjit. Megjithatë, nga pikëpamja formale, si dhe referuar përmbajtjes, kjo kontratë nuk është në përputhje me modelin e miratuar në Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit dhe gjithashtu konstatohet se nuk janë parashikuar përkufizimet, detyrimet e Kontrolluesit, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve etj.*

- *Për sa i përket konstatimit mbi përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV, Kontrolluesi ka deklaruar se sistemi i monitorimit i përbërë nga 8 kamera është instaluar në ambientet e Nisma ARSIS vetëm për sigurinë e stafit, të përfituesve (përfshirë fëmijët) dhe të pasurisë. Ai nuk monitoron hapësira publike. Para hetimit, aksesi në sistem rregullohej nga një autorizim i posaçëm për monitorimin e kamerave, dhe asgjësimi i të dhënave nga procedura dhe formulari i asgjësimit (dokumentet 13 dhe 14 të listës së provave). Pra, aksesi dhe fshirja kishin rregulla, edhe pse jo të përmbledhura në një rregullore të vetme. Në vijim, Kontrolluesi ka miratuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e sistemit të video-survejimit. Ky dokument paraqet mangësi referuar përputhshmërisë me Ligjin dhe Udhëzimin nr. 3, pasi në të nuk janë përcaktuar specifikimet teknike të pajisjeve CCTV dhe zonat e sakta të mbikëqyrjes me planvendosje, nuk është argumentuar arsyeja e zbatimit të afatit maksimal të ruajtjes së të dhënave personale prej 30 ditësh, nuk është bashkëlidhur modeli standard i tabelës informuese të miratuar nga Komisioneri dhe nuk janë plotësuar procedurat për autorizimin e aksesit, shikimin, kopjimin, dhënien, ruajtjen e veçantë dhe fshirjen e regjistrimeve, si dhe procesin e dokumentimit, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit.*

- *Në vijim, konstatohet se Kontrolluesi ka marrë masa duke caktuar një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave personale.*

- *Gjithashtu, referuar trajnimit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kontrolluesi ka deklaruar se ka planifikuar trajnime mbi përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke mos specifikuar nëse subjekti që do të kryejë trajnimin zotëron aftësitë juridike dhe kualifikimet e nevojshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.*

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara.

PËR KËTO ARSYE,

Në zbatim të neneve 6, 26, 27, 28, 29, 33 dhe 34 të Ligjit, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Kontrolluesi të rishikojë dhe të plotësojë dokumentin "Politika e Mbrojtjes së të Dhënave Personale", në përputhje me kërkesat e Ligjit, duke përcaktuar në mënyrë të qartë nivelet e aksesit, specifikisht për çdo punonjës që përpunon të dhëna personale, masat teknike dhe organizative të sigurisë, si dhe përgjegjësitë e personave të autorizuar. Gjithashtu, të hartojë dhe të mbajë Regjistrin e Veprimtarive të Përpunimit, të plotësojë procedurat për menaxhimin e cenimeve të të dhënave personale dhe marrëdhëniet me përpunuesit, si dhe të përcaktojë rregulla të posaçme për përpunimin e të dhënave të fëmijëve, të dhënave të shëndetit, duke garantuar respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, minimizimit, kufizimit të ruajtjes dhe përgjegjshmërisë, në zbatim të neneve 6, 26, 27, 28 e 29 të Ligjit.

2. Kontrolluesi të marrë masa për përfshirjen në shtesën e kontratës, të nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit, detyrimet për përcaktimin e rregullave specifike në lidhje me marrëdhënien mes palëve, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit.

3. Kontrolluesi të rishikojë dhe të plotësojë Rregulloren e Brendshme për administrimin e sistemit të video-survejimit (CCTV), në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, duke përcaktuar specifikimet teknike të pajisjeve CCTV dhe zonat e sakta të mbikëqyrjes, të pasqyruara në një planvendosje të kamerave. Gjithashtu, të argumentojë dhe të dokumentojë domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e afatit të ruajtjes së regjistrimeve deri në 30 ditë, në raport me qëllimin e përpunimit, si dhe të përfshijë modelin standard të tabelës informuese të miratuar nga Komisioneri. Kontrolluesi të plotësojë dhe të dokumentojë procedurat për autorizimin dhe kontrollin e aksesit në sistem, shikimin, kopjimin, vënien në dispozicion, ruajtjen e veçantë dhe fshirjen e regjistrimeve, duke përcaktuar përgjegjësitë e personave të autorizuar dhe mënyrën e dokumentimit të çdo veprimi,

në përputhje me kërkesat për sigurinë e përpunimit dhe përgjegjshmërinë, sipas neneve 27 dhe 28 të Ligjit.

4. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 1 dhe pikës 6 të nenit 34 të Ligjit lidhur me trajnimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave, si dhe punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre.

5. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:

   i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 1 dhe 2 më sipër;
   ii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 3 më sipër;
   iii) vazhdimisht detyrimin e treguar në pikën 4 më sipër.

   Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

6. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

7. Komisioneri, bazuar në shkronjën "a", pika 2 e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 27.10.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi